

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikaflex®-11 FC+

IZOLUES ELASTIK PËR FUGAT DHE NGJITËS SHUMË PËRDORIMESH PËR APLIKIME NË MJEDISE TË BRENDSHME & TË JASHTME



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikaflex®-11 FC+ është një izolues për fugat dhe ngjitës shumë përdorimesh me 1 përbërës, pa tretës dhe me konsistencë që nuk varet.

PËRDORIMET

Sikaflex®-11 FC+ është krijuar si një izolues fugash për fuga vertikale dhe horizontale, izolim akustik të tubave ndërmjet betonit dhe mbulesave mbrojtëse, për izolim ndarësesh, izolim tegelash, izolim në konstruksione druri dhe metali dhe për konstruksione ventilimi. Sikaflex®-11 FC+ është dizenuar si një ngjitës shumë përdorimesh për ngjitje të përvazeve të dritareve, pragjeve, shkallëve, blinduesve dhe elementeve të parafabrikuara në mjedise të brendshme e të jashtme.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Pa silikon
- Ndërkapje shumë e mirë mbi shumicën e materialeve të zakonshme të ndërtimit
- Nuk nevojitet ashpërsim i zonave që do të ngjiten
- Rezistencë e mirë mekanike
- Rezistencë e mirë ndaj kushteve atmosferike
- Absorbim i tronditjeve dhe vibrimeve
- Çlirime shumë të ulëta

INFORMACIONE MBI MJEDISIN

- EMICODE EC1^{PLUS} R
- LEED® EQc 4.1
- SCAQMD, Rule 1168
- BAAQMD, Reg. 8, Rule 51

MIRATIME / STANDARDE

- Certifikatë ISEGA për përdorim në mjedise përpunimi të ushqimeve

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Poliuretan i teknologjisë <i>i-Cure</i>
Ambalazhi	Tubetë 300 ml Sallam 600 ml
Ngjyra	E bardhë, gri betoni, kafe, bezhë.
Jetëgjatësia	Sikaflex®-11 FC+ ka një jetëgjatësi prej 15 muajsh nga data e prodhimit, nëse magazinohet saktë në ambalazhin origjinal, të padëmtuar dhe të mbyllur dhe nëse plotësohen kushtet e magazinimit.
Kushtet e magazinimit	Sikaflex®-11 FC+ duhet të magazinohet në kushtë të thata, i mbrojtur nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe në temperatura midis +5 °C dhe +25 °C.
Dendësia	~ 1.30 kg/l (ISO 1138-1)

TË DHËNA TEKNIKE

Fortësia Shore A	~ 37 (pas 28 ditësh)	(ISO 868)
Rezistenca ndaj tërheqjes	~ 1.5 N/mm ²	(ISO 37)
Moduli i shformimit elastik	~ 0.60 N/mm ² (pas 28 ditësh) (23 °C)	(ISO 8339)
Zgjatimi deri në thyerje	~ 700%	(ISO 37)
Risjellja elastike	~ 75% (pas 28 ditësh)	(ISO 7389)
Rezistenca ndaj përhapjes së grisjes	~ 8.0 N/mm	(ISO 34)
Rezistenca kimike	Sikaflex®-11 FC+ ka rezistencë ndaj ujit, ujit të detit, alkaleve të holluara, grautit prej çimentoje dhe detergjenteve të tretura në ujë. Sikaflex®-11 FC+ nuk ka rezistencë ndaj alkooleve, acideve organike, alkaleve dhe acideve të përqëndruara, lëndëve djegëse (hidrokarburëve) të klorinuara. Për informacione të detajuara, ju lutemi kontaktoni me departamentin tonë të shërbimit teknik.	
Temperatura e funksionimit	-40 °C deri në +80 °C	

Projektimi i fugës

Gjerësia e fugës duhet të projektohet për t' u përshtatur me lëvizjen e kërkuar të fugës dhe kapacitetin e izoluesit për lëvizje. Gjerësia e fugës duhet të jetë ≥ 10 mm dhe ≤ 35 mm. Duhet të ruhet një raport i gjerësisë me thellësinë prej 1:0.8 për fuga dyshemeje dhe 2:1 për fuga fasade.

Gjerësitë standarde të fugavepër fuga midis elementeve prej betoni:

Distanca e fugës [m]	Gjerësia min. e fugës [mm]	Thellësia min. e fugës [mm]
2	10	10
4	15	10
6	20	10
8	30	15
10	35	17

Të gjitha fugat duhet të projektohen saktë dhe dimensionohen në përputhje me standardet përkatëse, përpara ndërtimit të tyre. Baza për llogaritjen e gjerësive të nevojshme të fugave janë lloji i strukturës dhe përmasat e saj, vlerat teknike të materialeve të ndërtimit dhe materiali i izolimit të fugës, si dhe gjithashtu ekspozimi specifik i ndërtesës dhe fugave.

Fugat ≤ 10 mm në gjerësi janë për kontroll të plasaritjeve dhe si pasojë janë fuga jo lëvizëse. Vlerat e përmendura i përkasin gjerësisë së fugës në kohën e aplikimit të izoluesit (vlerë referencë +10 °C).

Për fuga më të gjera, ju lutemi kontaktoni me departamentin e shërbimit teknik.

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi

Konsumimi i përafëruar për fugat e dyshemesë

Gjatësia e fugës [m] për 600 ml	Gjatësia e fugës [m] për 300 ml	Gjerësia e fugës [mm]	Thellësia e fugës [mm]
6	3	10	10
2.5-3	1.5	15	12-15
1.8	0.9	20	17
1.2	0.6	25	20
0.8	0.4	30	25

Gjerësia minimale e fugës për fugat perimetrike të dritareve është 10 mm.

Material mbështetjeje

Përdorni kordona prej shkume polietileni të llojit të mbyllur.

Rrjedha e varjes

6 mm (profil 20 mm, 23 °C)

(ISO 7390)

Temperatura e mjedisit	+5 °C deri në +40 °C, min. 3 °C mbi temperaturën e pikës së vesës	
Lagështia relative e ajrit	30% deri në 90%	
Temperatura e nënshtresës	+5 °C deri në +40 °C	
Ritmi i maturimit	3.5 mm/ ~ 24 orë (23 °C / 50% lagështi relative)	(CQP 049-2)
Koha e krijimit të kores	~ 70 minuta (23 °C / 50% lagështi relative)	(CQP 019-1)

UDHËZIME APLIKIMI

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Nënshtresa duhet të tjetë e pastër, e thatë, e qëndrueshme dhe homogjene, pa vaj, graso, pluhur, materiale të lira dhe të shkrifëta. Boja, korja e çimentos dhe kontaminues të tjerë që nuk janë ngjitur mirë duhet të hiqen. Sikaflex®-11 FC+ ndërkapet pa prajmer dhe/ose aktivizues.

Megjithatë, për ndërkapje të mirë dhe aplikime kritike që kërkojnë performancë të lartë, si p.sh. ndërtesat shumëkatëshe, fugat në sforcim të lartë, ekspozim në kushte ekstreme moti apo prani e përhershme uji, duhet të ndiqen procedurat e mëposhtme të lyerjes me prajmer dhe/ose të trajtimit paraprak:

Nënshtresa joporoze

Pllakat me glazurë, metalet të veshura me pluhur, alumini, alumini i anodizuar, çeliku i pandryshkshëm dhe i galvanizuar duhet të trajtohen me një letër abrazive shumë të imët dhe Sika® Aktivator-205 duhet të aplikohet duke përdorur një pecetë të pastër. Përpara izolimit lini kohë tharjeje prej > 15 minutash. Të gjitha sipërfaqet metalike që nuk janë përmendur më sipër, duhet të trajtohen me një letër abrazive shumë të imët dhe Sika® Primer-3 N duhet të aplikohet duke përdorur një furçë ose rul të pastër. Përpara izolimit lini kohë tharjeje prej > 30 minutash (< 8 orë). PVC duhet të trajtohet paraprakisht me Sika® Primer-215 të aplikuar me një furçë të pastër. Përpara izolimit lini kohë tharjeje prej > 30 minutash (< 8 orë).

Nënshtresa poroze

Betoni, betoni me peshë të lehtë dhe suvatë me bazë çimentoje, llaçet, tullat dhe guri natyror duhet të lyhen me prajmerin Sika® Primer-3 N të aplikuar me një furçë të pastër. Përpara izolimit lini kohë tharjeje prej > 30 minutash (< 8 orë).

Për këshilla të detajuara, ju lutemi kontaktoni me departamentin e shërbimit teknik.

Shënim: Prajmerat janë përmirësues të ndërkapjes. Ato nuk zëvendësojnë pastrimin e duhur të sipërfaqes dhe as nuk përmirësojnë ndjeshëm rezistencën e sipërfaqes.

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Sikaflex®-11 FC+ është gati për përdorim. Pas përgatitjes së nevojshme të nënshtresës, vendosni një kordon të përshtatshëm për mbështetje në thellësinë e kërkuar dhe aplikoni prajmer nëse nevojitet. Vendosni tubetën tek pistoletat dhe nxirni Sikaflex®-11 FC+ tek fuga duke u siguruar se është në kontakt të plotë me anët e fugës dhe shmangni çdo bllokim ajri. Izoluesi Sikaflex®-11 FC+ duhet të ngjeshet

mirë tek anët e fugës për të siguruar ndërkapje të mjaftueshme.

Rekomandohet të përdoret shirit kudo që kërkohen vija të sakta ose vija të drejta fugash. Hiqni shiritin brenda kohës së krijimit të kores. Mos përdorni produkte që përmbajnë tretës.

Pas përgatitjes së nënshtresës, aplikoni Sikaflex®-11 FC+ në formë shiriti ose pikash tek sipërfaqja e ngjitjes me distancë prej disa centimetrash secila.

Ushtroni presionin e dorës vetëm për të fiksuar në pozicion elementin që do të ngjitet. Nëse nevojitet, përdorni shirita ngjitës, pyka ose mbështetëse për të mbajtur pjesët e montuara bashkë gjatë orëve të para të tharjes.

Një element në pozicion të gabuar mund të hiqet dhe rivendoset sërish në pozicionin e saktë gjatë minutave të para pas aplikimit.

Përftohet ngjitje më e mirë pas tharjes së plotë të Sikaflex®-11 FC+, p.sh. pas 24 deri 48 orësh në +23 °C për trashësi ngjitësi midis 2 deri në 3 mm.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit menjëherë pas përdorimit me Sika® Remover-208 dhe/ose Sika® TopClean T. Pas tharjes, materiali i mbetur mund të hiqet vetëm mekanikisht.

DOKUMENTA SHITESË

- Fleta e të dhënave të sigurisë
- Tabela e parapërgatitjes së materialeve për izolim dhe ngjitje

KUFIZIME

- Izoluesit elastikë nuk duhet të lyhen me bojë përsipër, sepse bojërat kanë kapacitet të kufizuar lëvizjeje dhe kështu do të plasariten gjatë lëvizjes së fugave.
- Ndryshimet në ngjyrë mund të ndodhin për shkak të ekspozimit ndaj kimikateve, temperaturave të larta dhe/ose rrezatimit UV (veçanërisht në ngjyrën e bardhë). Megjithatë, ndryshimi i ngjyrës ka natyrë plotësisht estetike dhe nuk ndikon negativisht mbi performancën teknike apo qëndrueshmërinë e produktit. Përpara përdorimit mbi gurin natyror kontaktoni me shërbimin tonë teknik.
- Përpara se të përdorni Sikaflex®-11 FC+ mbi gurin natyror, ju lutemi këshillohuni me departamentin teknik.
- Mos përdorni Sikaflex®-11 FC+ si izolues xhamash, mbi nënshtresa bituminoze, gomë natyrore, gomë EPDM apo mbi materiale ndërtimi prej të cilave mund të rrjedhë vaj, plastifikatorë apo tretës të cilët mund të sulmojnë izoluesin.

- Mos përdorni Sikaflex®-11 FC+ për të izoluar fugat brenda dhe përreth pishinave.
- Mos përdorni Sikaflex®-11 FC+ për fugat në presion uji apo për ato përherë brenda ujit.
- Mos ekspozoni Sikaflex®-11 FC+ që nuk është tharë në produkte me përmbajtje alkooli pasi mund të bashkëveprojnë gjatë reaksionit të tharjes.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla saqë asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sikaflex®-11 FC+

Mars 2019, Botimi 01.01

020513010000000019

Sikaflex-11FC+-sq-AL-(03-2019)-1-1.pdf